

K O N T R A T E
PER THEMELIMIN E SHOQERISE
"MEDIA J-7" SHPK



NDERMJET:

1. Luljeta DIMUSHI e bija L Lazarit e dtl.17.04.1967, lindur ne Berat e banuese ne Tirane Rruga "Komuna e Parisit" P.140/1
2. Mirgen DHIMA i biri Sotirit i dtl.26.03.1977, lindur ne Lushnje e banuese ne Tirane Rruga "Frederik Shiroka" NR.22
3. Brunilda MUHA e bija Fuatit e dtl.14.08.1979, lindur ne Tepelene banuese ne Tirane Rruga "Thanas Ziko" P.65/2 shk.1 ap.25.

Te lartpermendurit kane rene dakort qe te krijojne nje **SHOQERI ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR** ne baze te vullnetit te tyre te lire dhe te plote dhe ne baze te Ligjit Nr.7638 date 19.11.1992."Per Shoqerite Tregetare" dhe ligjit Nr.7667 date 28.01.1993."Per Rregjistrin Tregetar", si dhe ligjit Nr.5712 date 10.08.1991."Per Sanksionimin dhe Mbrojtjen e Prones Private e Nismes se Lire, Veprimtarise Private dhe Privatizimit" si me poshte:

Neni 1

Te themelojne nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar per te ushtruar veprimtari private me emertimin "MEDIA J-7" shpk .

Kjo shoqeri e ka Seline ne Tirane Blloku "Vasil Shanto" Pallati i Ri perballe K.E.SH.

Periudha e veprimtarise se shoqerise nga momenti i marjes se lejes per ushtrimin e aktivitetit mbi 20 vjet.

Shoqeria "MEDIA J-7" shpk ka te drejte te hape filiale brenda dhe jashte vendit ne cdo kohe qe te çmohet e aresyeshme prej saj dhe me miratim te organeve kopetente.

NENI 2

Shoqeria "MEDIA J -7" shpk gezon statusin e personit juridik.

Veprimtaria e saj do te zhvillohet sipas dispozitave te kesaj kontrate, statutit te saj dhe legjislacionit ne fuqi.Statuti i shoqerise i bashkangjitet kesaj kontrate dhe eshte pjese perberese e saj.

Shoqeria ne mardhenie me te tretet pergjigjet vetem me fondet e saja dhe ortaket pergjigjen vetem per detyrimet e kesaj shoqerie.

Dumir Mula

W. Z. 2001

Brunilda Muha

NENI 3

Shoqeria " MEDIA J -7" shpk do te kete si objekt te veprimtarise:

1. Drejtimi i radios/televizionit lokal dhe i rjeteve radiofonike/televizive lokale, vendosja dhe perdorimi i impianteve fikse dhe te levizshme, per transmetime radiofonike dhe televizive, lokale, mirembajtja, riparimi instalimi, montimi i makinave dhe aparaturave elektronike dhe elektrike te telekomunikacionit, ne funksion te veprimtarise se shoqerise.

NENI 4

Kapitali themeltar i shoqerise "MEDIA J-7"shpk eshte 100.000 leke i investuar nga ortakët ne kete menyre midis tyre :

- | | |
|--------------------------|-----|
| 1- Luljeta DIMUSHI | 40% |
| 2- Mirgen DHIMA | 30% |
| 3- Brunilda MUHA | 30% |

Ky kapital eshte i ndare ne 100 pjese ku njera pjese eshte e barabarte me 1000 leke (njemije leke)dhe kuotat e secilit ortakë jane si me siper.

NENI 5

Kapitali themeltar i shoqerise sipas nenit 4 te kesaj kontrate perfaqeson kapitalet e derdhura nga secili ortak te nevojshme per veprimtarine e shoqerise.

Sips kerkeses se ligjit Kapitali Themeltar do te depozitohet ne nje nga bankat e Shtetit Shqiptar.Kapitali Themeltar mund te jete i shprehur edhe ne natyre vleresimi i te cilit do te jete sipas legjislacionit te dale per kete qellim.

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne kete shoqeri do te shenohet edhe kapitali i derdhur nga cdo ortak.Rritja e kapitalit te ortakëve nuk eshte e kufizuar.

NENI 6

Shoqeria e pushon aktivitetin e saj me afatin e percaktuar ne kete kontrate ose per shkaqe te perligjura qe gjykohen te tilla nga ortakët.

Fitimi qe do te realizohet nga veprimtaria e kesaj shoqerie pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet eshte plotesisht i transferushem per t'u depozituar ne nje nga bankat jashte Shqiperise.

Fitimi neto do te ndahet ndermjet ortakëve sipas pjeseve te kontributit per krijimin e Kapitalit Themeltar.

NENI 7

ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE JANE

Brunilda Muha

Luljeta Dimushi

Mirgen Dhima

- ASAMBLEJA E ORTAKEVE .
- ADMINISTRATORET
- EKSPERTI KONTABEL

Modalitetet per perberjen dhe funksionimin e organeve te mesiperme percaktohen ne statutin e Shoqerise.

NENI 8

Ortaket jane te detyruar te ruajne sekretin e dokumentacionit, informacioneve, njohjeve dhe te eksperiences se kembyer e te realizuar, brenda shoqerise dhe te marin te gjitha masat per te evituar perhapjen e tyre qofte edhe te pjesshme.

Ortaket jane pergjegjes per pasojat e demshme e te shkeljeve ndaj ligjit "Per Shoqerite Tregetare".

NENI 9

VLEFSHMERIA E KONTRATES

Kjo kontrate eshte e vlefshme per nje periudhe mbi 10 vjet .Ortaket kane te drejte te heqin dore nga kjo kontrate duke lajmeruar ortakun tjetër 30 dite perpara.

Lajmerimi behet me shkrim.

NENI 10

Konfliktet qe lindin ndermjet ortakeve duhet te zgjidhen me marveshje midis tyre.Ne qofte se ortakët nuk meren vesh per zgjidhjen e konflikteve me mirekuptim,kompetente per zgjidhjen e ketyre konflikteve eshte Gjykata e Rrethit Tirane.

NENI 11

Dispozita me te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

NENI 12

Kjo kontrate formulohet ne 4 (kater) kopje nga te cilat njera depozitohet ne Zyren e Noterise,njera ne Gjykaten e Rrethit Tirane,njera ne Zyren e Tatimeve dhe kopja e katert mbahet ne dokumentat e shoqerise.

Kontrata eshte e vlefshme qe nga momenti i nenshkrimit te saj nga te dy ortakët.

Bruna Kuba

U. K. 2001
[Signature]

[Signature]



ORTAKET

LULJETA DIMUSHI

Luljeta Dimushi

MIRGEN DHIMA

Mirgen Dhima

BRUNILDA MUHA

Brunilda Muha

**REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE**

NR. 3031 REP.

M 191 kal.

VERTETIM

Sot me date 15.06.2001 (dymije e nje) ne Dhomen e Noterise ne Tirane, para meje Noteres u paraqiten personalisht Luljeta DIMUSHI e bija Liazarit e dtl.17.04.1967 lindur ne Berat, Mirgen DHIMA i biri Sotirit i dtl.26.03.1977, lindur ne Lushnje. Brunilda MUHA e bija Fuatit e dtl.14.08.1979, lindur ne Tepelene, banuesa ne Tirane, per identitetin e tyre u sigurova nga pasaporta personale, madhore, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar te cilet deklarojne se kontrata e themelimit eshte hartuar sipas vullnetit te tyre te lire dhe nenshkruan rregulisht para meje dhe une noterja e vertetoj ne baze te ligjit.

PULLE TAKSE



NOTERE

NOTERE

ERMIRA RIZAJ

Tel Fax 307-23

Ermira Rizaj

Brunilda Muha

Mirgen Dhima

Luljeta Dimushi



STATUT
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"MEDIA J-7" SHPK

KREU 1

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "MEDIA J -7" shpk themelohet ne perputhje me ligjin Nr.7638 date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregetare"

Kjo shoqeri krijohet nga ortaket :

1. Luljeta DIMUSHI e bija Llazarit e dtl.17.04.1967, lindur ne Berat e banuese ne Tirane Rruga "Komuna e Parisit" P.140/1
2. Mirgen DHIMA i biri Sotirit i dtl.26.03.1977, lindur ne Lushnje e banuese ne Tirane Rruga "Frederik Shiroka" NR.22
3. Brunilda MUHA e bija Fuatit e dtl.14.08.1979, lindur ne Tepelene banuese ne Tirane Rruga "Thanas Ziko" P.65/2 shk.1 ap.25.

Ortaket e lartpermendur kane krijuar nje Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar te emertuar "MEDIA J -7" shpk.

NENI 2

Shoqeria "MEDIA J -7" shpk e zhvillon veprimtarine e saj ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentat e krijimit te saj (kontrates dhe ketij statuti).

Shoqeria "MEDIA J -7" shpk eshte person juridik. Ajo fiton te drejten e personit juridik nga data e regjistrimit ne Rregjistrin Tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane.

NENI 3

Brunilda Muha

17/11/2017

Shoqeria



Shoqeria "MEDIA J -7" shpk krijohet per te ushtruar veprimtarine e saj per nje kohezgjatje mbi 20 vjet.

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane Blloku "Vasil Shanto" Pallati i Ri perballe K.E.SH.-it.

Kjo shoqeri mund te zgjate afatin e veprimtarise se saj ose munde ta mbylle aktivitetin e saj para ketij afati, sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut dhe sipas kriterëve qe percaktohen nga legjislatiioni ne fuqi

NENI 4

Shoqeria "MEDIA J -7" shpk per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet ,pergjigjet vetem me pasurine e saj.Ortakët e kesaj shoqerie nuk pergjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurine e tyre qe nuk eshte futur ne kapitalin e kesaj shoqerie.

Pjesemarja ne kete shoqeri nuk i pengon ortakët te kene pavarsi ligjore,organizative dhe te drejta pronesie jashte kesaj shoqerie.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

NENI 5

Shoqeria " MEDIA J-7" shpk do te kete si objekt te veprimtarise:

1. Drejtimi i radios/televizionit lokal dhe i rjeteve radiofonike/televizive lokale, vendosja dhe perdorimi i impianteve fikse dhe te levizshme, per transmetime radiofonike lokale mirembajtja, riparimi instalimi, montimi i makinave dhe aparaturave elektronike dhe elektrike te telekomunikacionit, ne funksion te veprimtarise se shoqerise.

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6

Kapitali themeltar i shoqerise "MEDIA J-7" shpk eshte prej 100.000 leke.

Ky kapital themelor zoterohet nga te dy ortakët ne kete menyre :

- 1- Luljeta DIMUSHI 40%
- 2- Mirgen DHIMA30%
- 3- Brunilda MUHA30%

Kapitali themeltar ose pjese te caktuara te tij jane te trasferushme si ndermjet ortakeve ashtu edhe perkundrejt personave te trete.Trasferimi i kapitalit ose pjeseve te tij ndermjet ortakeve ose ne favor te nje personi te trete behet gjithmon me miratim unanim te te gjithë ortakeve dhe me akt noterial.

Ne qofte se njeri nga ortakët deshiron te shese pjesen e kapitalit te tij ne natyre, duhet te respektoje te drejten e parablerjes nga ortakët e tjere.

Te gjithë veprimet e shoqerise mbi kapitalin themeltar behen me miratimin e te gjithë ortakeve.Vleresimi i kapitalit themeltar ne natyre behet nga ortakët me nje mareveshje te vecante ose nga nje ekspert kompetent i caktuar nga ortakët.

Brunilda Muha

Luljeta Dimushi

Mirgen Dhima

NENI 7

Kapitali themeltar eshte i ndare ne 100 pjese ku njera pjese eshte e barabarte me 1000 leke (njemije leke),dhe kuotat e secilit ortak jane percaktuar nga

NENI 8

Zmadhimi dhe zvogelimi i ketij kapitali vendoset nga Asamblea e Ortakeve. Pas derdhjes se kapitalit nga ortakët shoqëria i jep secilit nga një vertetim ku vertetohet se sa kuota te kapitalit te shoqërise i perkasin atij dhe vleren nominale perkatese.

Kapitali i shoqërise mund te shtohet me vendim unanim te Asamblese se ortakeve e cila do te percaktoje formalitete per pranimin e pjesmaresve te rinj, Per cdo pjesmarres te ri qe do te pranohet , shoqëria jep nga një vertetim per numrin e kuotave qe zoteron dhe vleren nominale te tyre.

Ne rast se kuotat e kapitalit te shoqërise transferohen ne favor te një personi te trete ai merr automatikisht te gjitha te drejtat dhe detyrimet qe ka ortaku qe dorezon kuotat perfshi edhe ato lloj detyrimesh qe ortaku shites ka mare mbi vehte duke firmosur kontraten per themelimin e shoqërise. Kete gje ai duhet ta pranoje duke ju dhene konfirmimi me shkrim ortaakeve te tjere. Ne se nuk do te behet ky konfirmim me shkrim, shitja e kuotave një personi te trete konsiderohet e pa vlere.

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj ne baze te një pavaresie te plote ekonomike. Ajo nuk pranon asnje fare nderhyrje nga organet shteterore apo publike te cfaredo lloj qofshin, perjashtuar kontrollit qe ka te drejte te bejne organet shteterore ne baze te ligjeve ne fuqi.

KREU II

ORGANIZIMI DHE DREJTIMI ADMINISTRATIMI I SHOQERISE

NENI 9

Organi me i larte vendimor i shoqërise eshte Asambleja e Ortakeve. Secili ortak ka te drejte te marre pjese personalisht apo duke autorizuar me shkrim një person tjetër duke mos qene ortak. Cdo ortak ka aq vota sa kuota disponon ne kapital. Ajo vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, per shtimin dhe pakesimin e kapitalit themeltar, per emerime e shkarkime te administratorit, per emerimin e eksperteve kontabel, per pushimin, per hapjen e degeve ,perfaqesive dhe filialeve ne rrethet e tjera, per transferimin e shoqërise ne një forme tjetër, per zgjatjen a afatit, marrje ne pune dhe largimin nga detyra te drejtorit te pergjithshem, vendime per marrje pjese ne shoqëri te tjera, aprovimin e rregullores se shoqërise, kalimin e shoqërise ne likujdim si dhe e bilancit te mbylljes jashte likujdimit.

NENI 10

Boune Kluk

Kl. K. K.

Shoqëria

Vendimet e marra nga Asamblea e Ortakeve ne mbledhjet e zakonshme dhe te jashtezakonshme, ne perputhje me kete statut jane te detyrueshme dhe te zbatueshme per secilin ortak.

Mbledhja e Asamblese se Ortakeve te behet te pakten nje here ne vit.

Lajmerimi ne marjen pjese ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve duhet te behet 30 dite para dates se caktuar per zhvillimin e mbledhjes. Ne lajmerimin e mbledhjes duhet te jete ora, dita e vendi i zhvillimit te mbledhjes si dhe do te caktohet rëndi i dites per ceshtjet qe do te shqyrtohen.

Ne mbledhjen e asamblese se Ortakeve mbahet nje proces-verbal.

Secili ortak ka te drejte ku te doje tea perdore librin e ortakeve dhe ka te drejte te marre eksrakte te tij te vertetuara rregullisht.

Asamblea e Ortakeve mbledhjet e zakonshme i ben cdo vit brenda 4 muajve nga mbyllja e veprimtarive ekonomike te shoqerise.

Vendimet per te cilat nevojiten unanimiteti jane:

- Vendimet per shtimin apo pakesimin e kapitalit.
- Shtimi i periudhes se kohezgjatjes se shoqerise.
- Futja e shoqerise ne procesin e likujdimit para perfundimit te afatit te percaktuar per shkrijen e saj.
- Ndryshimet ne statut.

Cdo lloj vendimi tjeter merret me shumice te thjeshte votash.

NENI 11

Ortaket kane te drejte te marrin pjese ne aktivitetine shoqerise ne menyren e percaktuar ne Kontraten e themelimit dhe statutin. Te marre nje pjese te fitimeve te aktivitetit te shoqerise ne perpjestim me perqindjen e pjesmarjes se tyre ne kapitalin e shoqerise. Te marre informacion mbi aktivitetin e shoqerise pa kufare pengese. Ka te drejte te beje kontrollin e librave te shoqerise me ane te nje kontrollori te kualifikuar, vecse me shpenzimet e veta. Te marre pjese ne mbledhjen e Asamblese se Ortakeve, te marre nje pjese nga pasuria e shoqerise qe do te rezultoj si aktiv ne bilancin e likujdimit te shoqerise ne perpjestim me perqindjen e pjesmarjes se tij ne kapital.

Ortaket jane te detyruar te derdhin pjesen qe ju perket ne kapitalin e shoqerise ne mases, menyren dhe brenda kohes qe eshte percaktuar ne Aktin e Themelimit, apo qe mund te jete vendosur nga mbledhja e Asamblese se Ortakeve. Te zbatoj te gjitha vendimet e organeve drejtuese te shoqerise, te bashkpunojne njeri me tjetrin per te realizuar qellimet e shoqerise dhe per te cuar perpara zhvillimit e saj.

Shoqeria ka te drejte qe te transferoje lirisht jashte shtetit ne valuten qe deshiron ate pjese fitimi qe i takon, po keshtu edhe kundervleften e kuotave te kapitalit qe eventualisht mund te shese, apo vleften qe i perket asaj ne raste se shoqeria do te likujdohet.

NENI 12

Administratore e shoqerise "MEDIA J -7" shpk eshte Luljeta DIMUSHI e cila kryen veprime ne emer dhe per llogari te shoqerise.

Ne maredheniet me te tretet Administratori i ka te gjitha kompetencat per te kryer veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj, qe jane ne perputhje me objektin e shoqerise.

Bruce Mark

[Signature]

[Signature]

NENI 13

Mardheniet e punes me te punesuarit prane shoqerise rregullohen me kontrata individuale qe do te lidhen me sejcilin prej tyre ne baze te ligjeve ne fuqi.

NENI 14

Kontrrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per tre vite financiare me mundesi rizgjedhje. Ai caktohet nga mbledhja e Asamblese se Ortakeve.

Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar, vendoset me te njejta kondita si emerimi, ne raste se verehen gabime ne punen e tij, gje qe ben te pamundur kryerjen e detyres.

KREU III**MARRREDHENIET EKONOMIKO - FINANCIARE****NENI 15**

Viti financiar fillon me daten 1 Janar dhe mbaron me daten 31 Dhjetor te cdo viti.

Llogarite vjetore, inventari, raportet dhe operacionet e vitit financiar e raportet e vecanta te hartuara nga Administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asambleja e Ortakeve.

Miratimi i bilanceve dhe dokumentacioni mbi veprimtarine vjetore behet brenda muajit Mars te vitit pasardhes.

NENI 16

Pas miratimit te llogarive vjetore dhe evidentimit te fitimit, Asambleja e Ortakeve percakton pjesen e fitimit qe i takon sejcilit ortak, mbasi te jene zbritur shumat e lena menjan per fondin rezerve te domosdoshem, ajo pjese qe mbetet nga fitimi pasi te jene zbritur pjesa qe do te kaloje ne fondin rezerve, pjesa per fondet e tjera eventuale dhe pasi te jene likujduar te gjitha detyrimet tatimore, ju perket ortakeve te cilet kane te drejte ta disponojne teresisht.

NENI 17

Llogarite ekonomike dhe ato kontabel mbahen ne Shqiperi ne leke ose valute te huaj.

Veprimtaria ekonomike mbahet ne baze te akteve ligjore dhe nenligjore te dala per kete qellim dhe mbeshtetet ne aktivin dhe pasivin qe detyrimisht do te pasqyrohen ne bilancet e perpiluara nga ekspertet kontabel te autorizuar te cilet mbajne pergjegjesi ligjore per punen e tyre.

Shoqeria me qellim qe te lehtesoje punen dhe te beje sa me shpejt pagesat me te tretet do te hap llogari bankare ne nje nga Bankat qe jane te njohura nga shteti Shqiptar, vendase ose e huaj.

KREU IV

ZGJATJA E AFATIT, PRISHJA, LIKUJDIMI

NENI 18

Me mbarimin e afatit te percaktuar ne kontraten e themelimit, zgjatja e tij behet vetem me vendimin e Asamblese se Ortakeve.

Ajo priset kur mbaron afati i percaktuar dhe ortaket nuk kan rene dakort qe te bejne ripertitjen e ketij afati.

Shoqeria mund te shnderohet ne nje nga format e percaktuar nga ligji dhe ne formen e kerkuar nga ligji.

NENI 19

Shoqeria tregtare hyn ne procesin e likuidimit qe ne momentin e vendosjes per prishjen e saj. Per fillimin e ketij procesi Asambleja e Ortakeve emerone nje likuidator i cili paraqet raportin e likuidimit, gjendjen e aktivitetit dhe te pasivitetit te shoqerise, mbi menyren e ndjekies se operacionit te likuidimit dhe afatin e nevojshem per perfundimin e tyre.

Ne fund te procesit te likuidimit Asambleja e Ortakeve vendos mbi bilancin perfundimtar, mbi aktin dhe rregullsine e likuidimit, mbi mbylljen e procesit te likuidimit te shoqerise.

NENI 20

Zgjidhja e mosmarveshjeve ndermjet ortakeve eshte percaktuar ne aktin e themelimit te shoqerise.


Mosmarveshjet qe mund te lindin ndermjet shoqerise dhe te tretave lidhur me mardheniet kontraktuale ndermjet tyre do te zgjidhen sipas klauzolave arbitrare qe shoqeria do te kete kujdes ti perfshije ne secilen nga kontratat qe do te lidhin.

NENI 21

Ky statut formulohet ne 4 (kater) kopje nga te cilat njera depozitohet ne Zyren e Noterise, njera ne Gjykatën e Rrethit Tirane, njera ne Zyren e Tatimeve dhe kopja e katert mbahet ne dokumentat e shoqerise.

ORTAKET

LULJETA DIMUSHI



MIRGEN DHIMA



BRUNILDA MUHA

